

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
 MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS  
 MINISTARSTVO INFRASTRUKTURE  
 MINISTRY OF INFRASTRUCTURE

KM-MIT-01  
 Nr. Prot. 314/19  
 Broj Prot. 314/19  
 Pro. Sub.

Dura: 2  
 Datum: 13.05.19  
 Date: 13.05.19

PRISHTINË/A



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
 MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS  
 MINISTARSTVO INFRASTRUKTURE  
 MINISTRY OF INFRASTRUCTURE

Nr. I Prot. 4974  
 Broj Prot. 4974  
 Prot. No.

Nr. I Fajevë 2  
 Broj Stranica 2  
 No. Pages

Data: 13.05.19  
 Datum: 13.05.19  
 Date: 13.05.19

PRISHTINË/A

**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria -Vlada-Government**

**Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit**  
**Ministarstvo Infrastrukture i Transporta**  
**Ministry of Infrastructure and Transport**

Ministri i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit , në mbështetje të nenit 145 (paragrafi 2) , të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 17 (paragrafi 5 dhe paragrafi 6) dhe nenin 38 (paragrafi 3) të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (22.03.2011), Rregulloren Nr.26/2018 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenin 131 të Ligjit nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenin 5 dhe 21 të Ligjit nr.04/L-179 për Transportin Rrugor, nenin 7 të Udhëzimit Administrativ 09/2013 për rrjetin e linjave dhe rendin e udhëtimit të transportit ndërrurban të udhëtarëve me autobus dhe rekomandimit të komisionit profesional, nxjerr këtë:

**VENDIM**

**REFUZOHET** ankesa nr.2056 të datës 01.03.2019 parashtruar nga Shoqata e operatorëve të transportit rrugor të udhëtarëve "RAHOVECI" me seli në Rahovec, kundër vendimit nr.1643 të datës 21.02.2019 i ndryshuar dhe plotësuar me vendimin nr.1750 të datës 22.02.2019 mbi shpalljen e nisjeve të lira ndër-urbane nëpër regjione respektivisht nisjeve në relacionin Malishevë - Komaran- Prishtinë dhe ansajlltas me kohë të nisjes 09:35 - 12:45 ; 17:20 - 19:30 .

**ARSYETIM**

Komisioni i emëruar nga Ministri sipas vendimit nr.2259 datë 06.03.2019 pas shqyrtimit të ankesave, verifikimit të dokumentacionit dhe shkresave të tjera të lëndës dhe duke u bazuar në legjislacionin në fuqi respektivisht nenet 5 (paragrafi 4) dhe 7 të Udhëzimit Administrativ nr. 09/2013 mbi rrjetin e linjave dhe rendin e udhëtimit të transportit ndërrurban të udhëtarëve me autobus, poashtu duke pasë parasyshë rrjetin aktual të linjave ndër-urbane, konstaton se nisjet e shpallura në relacionin Malishevë - Komaran- Prishtinë (09:35 - 12:45 ; 17:20 - 19:30) nuk pengojnë në nisjet aktuale të vërtetuara nga MIT-ja në relacionin Rahovec - Malishevë - Prishtinë dhe Malishevë - Prishtinë pasi që koha minimale e operimit ndërmjet linjave/nisjeve aktuale në këtë relacion është pesëmbdhjetë (15) minuta, ndërsa nisjet (me orarë: 09:35 - 12:45 ; 17:20 - 19:30) të shpallura në relacionin e

lartëcekur kanë një diferencë kohore të operimit në kuadër të lilitimit të lartëcekur përkatësisht kan pesëmbdhjetë (15) minuta.

Andaj duke pasë parasysh të cekurat më lartë dhe duke iu referuar legjislacionit në fuqi Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit ka vlerësuar të domosdoshme shtimin e numrit të nisjeve të reja në mënyrë që të kemi shërbime të mjaftueshme për udhëtarët që frekuentojnë në këtë relacion duke krijuar një treg liberal me qëllim të ngritjes së cilësisë së shërbimeve dhe krijimin e mundësisve më të mëdha për qasje më të shpejtë dhe më lehtë në kryeqytet për qytetarët që shfrytëzojnë shërbimet e transportit me autobus.

Andaj në bazë të kësaj që u tha më lartë vendimi është marrë si në dispozitiv.

### **Këshilla Juridike:**

Kundër këtij Vendimi pala e pa kënaqur mund të parashtrorjë padi në Gjykatën kompetente në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.

#### **I dërgohet:**

- Kabinetit të Ministrit;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Parashtruesit të ankesës;
- Departamentit të Transportit Tokësor;
- Arkivit të MI -së

